

V E N D I M
Nr.76, datë 11.2.1999

**PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE
DHE TRAJTIMIN ME PAGË TË EFEKTIVAVE TË KËTYRE SHËRBIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8361, datë 1.7.1998, me ligjin nr.8421, datë 28.10.1998 dhe me ligjin nr.8452, datë 28.1.1999, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Presidentit të Republikës, Kryetari të Kuvendit dhe Kryeministrit u ruhet banesa ose rezidenca ku ndodhen dhe u bëhet ruajtja e shoqërimi me grup shoqërimi me tri makina.

2. Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Rendit Publik, Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm u ruhet banesa dhe u bëhet ruajtja e shoqërimi me grup shoqërimi, me dy makina.

3. Zëvendëskryetarëve të Kuvendit, Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Financave dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë u ruhet banesa dhe u bëhet ruajtja e shoqërimi me grup shoqërimi, me një makinë.

4. Anëtarëve të Këshillit të Ministrave, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të shtetit u bëhet ruajtja e afërt fizike me shoqërues personal.

5. Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit, pas lirimimit të tyre nga funksioni, u ruhet banesa ose rezidenca ku ndodhen dhe u bëhet ruajtja e shoqërimi me grup shoqërimi me një makinë.

6. Efektivi ushtarak e civil i strukturave që merren me ruajtjen dhe sigurimin e personaliteteve të larta shtetërore, të përcaktuara në këtë vendim, është pjesë e efektivit të Gardës së Republikës.

Struktura dhe përbërja organike, e nevojshme për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve, si dhe të banesave e rezidencave të tyre, sipas këtij vendimi, miratohen nga Ministri i Rendit Publik.

Anëtarëve të Këshillit të Ministrave u ruhet banesa ose rezidenca ku banojnë.

Në varësi të situatave, që paraqiten për kryerjen e shërbimit, Ministri i Rendit Publik ka të drejtë të rrisë numrin organik të shoqëruesve dhe të makinave, në funksion të ruajtjes e të shoqërimit të personaliteteve dhe të ruajtjes së banesave të tyre, sikurse përcaktohen në këtë vendim.

7. Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Rendit Publik, Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Financave, pas lirimimit nga funksioni, u bëhet ruajtje e afërt fizike, me shoqërues personal, në afatet maksimale të përcaktuara në ligjin nr.8421, datë 28.10.1998 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

8. Niveli i pagës bazë mujore për efektivat, që merren drejtpërdrejt me ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore, të jetë klasa XIII për funksionin më të ulët dhe klasa XVIII për funksionin më të lartë, sipas pagave të punonjësve të rendit. Shtesa për vështirësi shërbimi të jetë deri në 250 për qind.

9. Paga bazë mujore për funksionet e tjera, ushtarake e civile, në strukturën e degës së ruajtjes e të sigurimit të personaliteteve të larta shtetërore, të jetë e njëjtë me funksionet analoge në sektorë të tjerë, kurse shtesa për vështirësi shërbimi të jetë deri më 20 për qind më e lartë se funksionet analoge në strukturat e tjera të policisë.

10. Shtesa për vështirësi shërbimi, për çdo funksion, përcaktohet nga Ministri i Rendit Publik, me përjashtim të pagesave për mbikohë pune e shërbimi.

11. Efektivat, që trajtohen sipas këtij vendimi, përfitojnë edhe trajtime të tjera, ekonomike e financiare, si të gjithë punonjësit e tjerë të sistemit të Ministrisë së Rendit Publik, me përjashtim të pagesave për mbikohë pune e shërbimi.

Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, në limitin organik të Ministrisë së Rendit Publik, shtohen 20 punonjës, të cilët u zbriten ministrave, sipas listës nr.1, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

12. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.297, datë 22.7.1997 “Për ruajtjen e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave pas lirimimit nga funksioni” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.592, datë 22.12.1997 “Për ruajtjen dhe

shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore dhe trajtimin me pagë të efektivave të këtyre shërbimeve”, ndryshuar me vendimin nr.488, datë 29.7.1988, ndryshuar me vendimin nr.594, datë 19.9.1998, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LISTA NR.1
NUMRI I PUNONJËSVE QË HIQEN NGA ÇDO INSTITUCION DHE MINISTRI

1. Kuvendi	2	
		2. Kryeministria (për Ministrin e Shtetit për Reformën
Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin		1
3. Gjykata Kushtetuese		1
4. Gjykata e Lartë		1
5. Prokuroria e Përgjithshme		1
6. Kontrolli i Lartë i Shtetit		1
7. Ministria e Punëve të Jashtme	1	
8. Ministria e Drejtësisë	1	
9. Ministria e Financave	1	
10. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit		1
11. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale		1
12. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit		1
13. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit		1
14. Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë		1
15. Ministria e Arsimit dhe Shkencës		1
16. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve		1
17. Ministria e Shëndetësisë		1
18. Ministria e Informacionit		1
19. Shërbimi Informativ Kombëtar		1
Shuma:		20